



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 568/13 Prot.

Tiranë, më 13.02 2025

V E N D I M

Nr. 30 dt. 13.02 2025

“PËR  
MIRATIMIN E MARRËVESHJES TIP TË BASHKËPUNIMIT

PËR

ZHVILLIMIN E PRAKTIKËS MËSIMORE TË STUDENTËVE TË  
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS, PRANË INSTITUCIONEVE  
ARSIMORE PARAUNIVERSITARE PUBLIKE”

Mbështetur në nenin 3, pika 4 gërma c), nenin 38 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 6 të Vendimit nr.57, datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të vecantë Universitetit të Sporteve të Tiranës, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e sportit në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 7 pika 4, gërma d), nenin 23 pika 1 gërma ll), nenin 20 të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, në nenin 7 të Rregullores së UST-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 13.02.2025,

V E N D O S I :

1. Miratimin e marrëveshjes tip të bashkëpunimit për zhvillimin e praktikës mësimore të studentëve të Universitetit të Sporteve të Tiranës, pranë institucioneve arsimore parauniversitare publike” (bashkëlidhur vendimit).
2. Ky Vendim i përcillet për njohje, zbatim dhe publikim njëjësive kryesore të UST-së, Bordit të Administrimit dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR \_\_\_\_\_

ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR \_\_\_\_\_

Nr. \_\_\_\_ Prot, datë \_\_\_\_\_ 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

Nr. \_\_\_\_ Prot, datë \_\_\_\_\_ 2025

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

### PËR

ZHVILLIMIN E PRAKTIKËS MËSIMORE TË STUDENTËVE  
TË FAKULTETIT \_\_\_\_\_, UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS,  
PRANË INSTITUCIONEVE ARSIMORE PARAUNIVERSITARE PUBLIKE  
TË \_\_\_\_\_

ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR \_\_\_\_\_ (më poshtë referuar "ZVAP") e perfaqësuar nga Drejtori Z./Zj. \_\_\_\_\_ dhe UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS (më poshtë referuar "UST") i perfaqësuar nga Rektori Prof.Dr. Agron KASA, bien dakort për të bashkëpunuar si më poshtë:

#### Neni 1

#### Qëllimi

Kjo marrëveshje ka për qëllim institucionalizimin e bashkëpunimit ndërmjet Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar \_\_\_\_\_ dhe Universitetit të Sporteve Tiranë, në kuadër të zhvillimit të praktikës mësimore nga ana e studentëve të Fakultetit \_\_\_\_\_, pranë institucioneve arsimore parauniversitare publike të \_\_\_\_\_, për plotësimin e studimeve universitare të tyre në programin e ciklit \_\_\_\_\_.

#### Neni 2

#### Baza Ligjore

Kjo marrëveshje bazohet, në nenin 3, pika 4 gërma c) të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 69/2012 datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në pikën 6 të Vendimit nr.57, datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të vecantë Universitetit të Sporteve të Tiranës, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e sportit në Republikën e Shqipërisë”, shkronjën “f” të pikës 1 të Kreut I dhe pikës 12 të Kreut III të VKM Nr.77 datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” e ndryshuar; Urdhërit nr.31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 7 pika 4, gërma d) dhe 23 pika 1 gërma ll) të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, Rregulloren mbi kryerjen e praktikës mësimore si dhe në Planin Mësimor të Fakultetit \_\_\_\_\_.

### **Neni 3**

#### **Fusha e Zbatimit**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi, zbatohet midis strukturave të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar \_\_\_\_\_ dhe strukturave të Fakultetit \_\_\_\_\_, gjatë vitit mësimor 202\_-202\_, për përfshirjen e studentëve në zhvillimin e praktikës mësimore për periudhën \_\_\_\_\_.

Studentët e Fakultetit \_\_\_\_\_ do ta zhvillojnë praktikën mësimore në institucionet arsimore parauniversitare publike të \_\_\_\_\_.

Institucionet arsimore në të cilat do të zhvillohet praktika mësimore, do të përcaktohen nga ZVAP \_\_\_\_\_.

### **Neni 4**

#### **Detyrimet e UST-së**

1. UST cakton numrin e studentëve që do të zhvillojnë praktikën mësimore dhe preferencat/kërkesat për institucionet arsimore parauniversitare publike të \_\_\_\_\_, ku dëshirojnë të kryejnë praktikën mësimore studentët, por kërkesa në lidhje me caktimin e shkollave, do të shqyrtohet (në varësi të kushteve, kapaciteteve etj.) dhe miratohet nga ana e ZVAP \_\_\_\_\_ dhe do të jetë e përcaktuar sipas ndarjes së sanksionuar nën nenin 3 të kësaj marrëveshjeje.

2. UST depoziton para fillimit të praktikës mësimore, pranë drejtorisë së shkollës listën emërore të studentëve që do të zhvillojnë praktikën mësimore (me firmë dhe vulë nga fakulteti).
3. UST orienton studentët në lidhje me respektimin e rregullores së shkollës, orarin e përcaktuar nga drejtuesit e shkollës dhe modalitetet të tjera, me qëllim mos cënimit e procesit mësimor në këto institucione.
4. UST përcakton pedagogët e Fakultetit \_\_\_\_\_, që do të udhëheqin studentët në praktikën mësimore, në secilën shkollë ku do të kryhet praktika.
5. UST depoziton pranë ZVAP \_\_\_\_\_ dokumentin justifikues ligjor në lidhje me derdhjen e kontributit të detyrueshëm për studentin, në nivelin minimal, vetëm për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, për të gjithë periudhën e praktikës mësimore.

## Neni 5

### Detyrimet e ZVAP \_\_\_\_\_

1. ZVAP-ja lejon kryerjen e praktikës së studentëve të Fakultetit \_\_\_\_\_, për të zhvilluar praktikën mësimore pranë institucioneve arsimore parauniversitare publike të \_\_\_\_\_, sipas përcaktimeve dhe ndarjeve të specifikuara në nenin 3 të kësaj marrëveshjeje;
2. ZVAP-ja udhëzon drejtuesit dhe mësuesit e institucioneve arsimore parauniversitare publike të \_\_\_\_\_ në lidhje me zhvillimin e praktikës mësimore të studentëve pranë këtyre shkollave.
3. ZVAP-ja në bashkëpunim me drejtuesit e shkollave cakton një apo më shumë mësues (në varësi të numrit të studentëve) për orientimin, mbikqyrjen, mentorimin e studentëve gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të praktikës mësimore dhe në përfundim të saj e pajisin studentin me raportin e vlerësimit përfundimtar dhe fletë vlerësimit e praktikantit si dhe cdo dokument tjetër provues të kryerjes së praktikës mësimore.
4. ZVAP-ja kryen orientimin e drejtuesve të shkollave që mësuesi/it e caktuar si mentor të studentëve ti njoftohen pedagogut përgjegjës për studentët, me të dhënat si emër, mbiemër dhe kontaktet.
5. ZVAP-ja në bashkëpunim me drejtuesit e shkollave, kryen raportimin pranë Fakultetit \_\_\_\_\_, mbi problematikat e ndryshme që mund të jenë krijuar nga ana e studentëve gjatë zhvillimit të praktikës mësimore.

## Neni 6

### Koordinatorët e praktikës mësimore

Për ZVAP \_\_\_\_\_ caktohet si koordinator Z/Zj. \_\_\_\_\_ me  
detyrë \_\_\_\_\_.

Për Fakultetin \_\_\_\_\_, caktohet si koordinator Z./Zj. \_\_\_\_\_ me  
detyrë \_\_\_\_\_

### Neni 7

#### Dispozitat e fundit

1. Kjo marrëveshje hartohet në dy kopje origjinale, nga një për secilën palë.
2. Marrëveshja hyn në fuqi me nënshkrimin e të dy palëve dhe i shtrin efektet përgjatë vitit 202\_\_-202\_\_.
3. Për prishjen apo ndryshimin e kësaj marrëveshjeje, palët duhet të njoftojnë njëra-tjetrën një muaj përpara me shkresë zyrtare.

**ZYRA VENDORE E ARSIMIT**  
**PARAUNIVERSITAR** \_\_\_\_\_

**UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS**

**DREJTOR**

**Z/ZJ.**

**REKTOR**

**Prof.Dr. Agron KASA**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_